

SHENIME SHPJEGUESE

Shoqëria "FORALB ALABASTER" Sh.p.k. i ka ndertuar Pasqyrat Financiare në bazë të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit dhe përkatësisht në mbështetje të plotë të SKK2. Shoqëria i ndërton dhe i paraqet Pasqyrat Financiare sipas SKK në bazë të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", neni 4. Pasqyrat Financiare janë përgatitur duke ndjekur e zbatuar Politikën Kryesore Kontabel si : politika për njohjen e aktiveve, për njohjen e detyrimeve , njohjen e te drejtave ,njohjen e te ardhurave e shpenzimeve si dhe njohjen dhe vlerësimin e tyre. Gjithashtu gjatë përgatitjes së Pasqyrave Financiare janë pasur parasysh Parimet informacionit: si Parimi i te drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, Parimi i Njesise Ekonomike Raportuese, Parimi i vijimesise së veprimtarise ekonomike si dhe Parimi i Kompesimit. Karakteristikat çilesore të përgatitjes së Pasqyrave Financiare janë ato që e bëjnë informacionin e pasqyrave financiare të dobishëm për përdoruesin. Karakteristikat kryesore që janë mbajtur parasysh gjatë hartimit të Pasqyrave Financiare janë: Kuptueshmëria, Rëndësia dhe Materialiteti, Besueshmëria, Parimi i Paraqitjes me Besnikeri parimi i Perparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore, Paanshmëria, Parimi i maturisë, Parimi i plotësisë. Qëndrueshmëria dhe Krahasueshmëria .

Përmbledhje e politikave kontabel

Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar " Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare " dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit të të drejtave të konstatuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar (lekë).

Standartet Kombëtare të Kontabilitetit - TE PERMIRESUARA janë zbatuar dhe aplikimi i tyre, sipas kërkesave të SNK-ve, është bërë në mënyrë perspektive. Si pasojë shifrat e 2019 janë të krahasueshme me ato të vitit 2018, pasi janë zbatuar politika kontabel të njejta.

Në paraqitjen e pasqyrave financiare të vitit 2019 është zbatuar formati i SKK-2 si edhe në paraqitjen e pasqyrave financiare të vitit 2018.

Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:

Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej të tretëve dhe në të njëjtin ushtrim kontabel me të ardhurat e lidhura.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lek, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në cdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore më 31.12.2019:

Monedha

Viti 2019

Viti 2018

Ndryshimi

1 EUR	121.77	123.42	-1.65
1 USD	108.64	107.82	0.82
1 GBP	143.00	137.42	5.58
1CHF	112.30	109.60	2.7
1AUD	76.15	76.12	0.03

Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi I pagueshëm për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshëm I cili ndryshon nga fitimi tregëtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2019 është 15%.

Kerkesat për t'u arketuar

Kerkesat për t'u arketuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogarit të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arketuar në para regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuara. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arketuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënje në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme.

Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në para, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme.

Aktivitet Afatgjata Materiale

Gjendjet e inventarët

Vlerësimi në hyrje i inventarëve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjellë inventarët në kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve të fundit të ushtrimit që nga drejtimi është cmuar si vlera neto e realizueshme.

Në vijim do të gjeni pasqyrat përkatëse për të gjitha zerat e pasqyrave financiare të dorëzuara.

Per Smart Consulting



Per FORALB ALABASTER shpk

Anton Gjinaj
Administrator